

UDHËZIM
Nr. 5, datë 22.4.2015

**PËR ORGANIZIMIN E PUNËS NË VENDIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE,
RADHËN E VEPRIMEVE GJATË DORËZIMIT TË MATERIALEVE ZGJEDHORE,
NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE NXJERRJES SË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
ZONËN E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR**

Në mbështetje të nenit 23 pika 1 germa “b” dhe në bazë të nenit 94, pika 4, nenit 95, pika 5, nenit 115, nenit 116, nenit 116/1 nenit 117, nenit 118, nenit 119, nenit 120, nenit 121, dhe nenit 122 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të detajojë rregullat për mënyrën e organizimit të punës, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore nga komisioni i qendrës së votimit në vendin e numërimit të votave, për detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të grupit të numërimit të votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) organizon punën dhe garanton funksionimin korrekt të procesit të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, të procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor.

2. Grupi i numërimit të votave (GNV) nxjerr rezultatin e zgjedhjeve për çdo qendër votimi që numëron.

3. Grupi i numërimit të votave përbëhet nga 4 anëtarë, ku një nga anëtarët është numëruar i parë, një sekretar dhe 2 anëtarë.

4. Grupi i numërimit të votave funksionon minimalisht me 2 anëtarë.

Neni 3

Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave

1. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave instalohet në çdo VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me sistemin e teknologjisë mbështetëse përkatëse.

2. KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të zonës së administrimit zgjedhor.

3. Grupi i numërimit të votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamerë, sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzim.

4. Në rast se sistemi i teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave ka defekt në një apo më shumë tavolina numërimi, nuk pengohet procesi i numërimit të votave.

5. KZAZ-ja njofton menjëherë ndihmësit teknikë dhe KQZ-në për defektin e ndodhur. GNV-të vazhdojnë procesin e numërimit të votave. Në këtë rast KZAZ-ja lejon vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore që nuk kanë anëtar në GNV të afrohen pranë tavolinës së numërimit të votave. Kjo procedurë dhe ora e saktë e ndërprerjes dhe rifillimit të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve.

6. Në rast se grupi i numërimit të votave funksionon me 2 anëtarë sipas përcaktimit të nenit 95 pika 3 të Kodit Zgjedhor, detyrimisht procesi i numërimit të votave duhet të jetë i regjistruar nga kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluar në ambientet e VNV-së. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon për çfarëdo arsye dhe numërimi i kutisë nuk ka përfunduar, atëherë numëruesit

përfundojnë numërimin e kësaj QV-je, dhe procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse (kamerave), ose plotësimin e grupit të numërimit të votave.

Kjo procedurë dhe ora e saktë e ndërprerjes dhe rifillimit të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit, apo e plotësimit të grupit të numërimit të votave shënohen në procesverbalin e konstatimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.

PJESA II MARRJA NË DORËZIM E MATERIALIT ZGJEDHOR NGA KZAZ-JA

Neni 4

Caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim

1. Për marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë/kutive me materialet e votimit nga KQV-të, KZAZ-ja cakton një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim.

2. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së, me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

3. Nëse është e nevojshme, KZAZ-ja cakton dy persona në ndihmë për çdo grup të marrjes në dorëzim, nga lista e anëtareve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Në caktimin e tyre duhet pasur parasysh përkatësia politike dhe baraspeshimi shumicë-opozitë. Propozimet për caktimin e këtyre dy personave bëhen nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Neni 5

Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim

1. Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, caktohet dhe funksionon vetëm për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-të në VNV.

2. Kutia/kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit të çdo QV-je merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në VNV sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV.

Neni 6

Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor

1. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedurë:

a) Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV. Kjo dosje përmban: procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave dhe modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së.

b) Shënon në procesverbalin e marrjes në dorëzim numrat e kodeve të sigurisë të vulave me të cilat është mbyllur kutia/kutitë e votimit dhe kutia me materialet e votimit.

c) Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutia/kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë të vulave të shënuara në procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave nga KZAZ-ja në KQV.

c.1) Në rast mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë të vulave, grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”.

c.2) KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen e konstatuar nga grupi i marrjes në dorëzim dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë sipas pikës “f” të këtij neni.

c.3) Mospërputhjet e konstatuara shënohen nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim, dhe nga KZAZ-ja në librin e protokollit të mbledhjeve dhe procesverbalin e konstatimit.

ç) Verifikon nëse mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;

d) Verifikon nëse vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;

dh) Verifikon nëse kutia ka në trupin apo në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo

nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit;

e) Verifikon nëse kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së.

ë) Në rast se grupi i marrjes në dorëzim, gjatë marrjes në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit konstaton të paktën njërën nga parregullsitë e përcaktuara në germenat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, njofton menjëherë KZAZ-në dhe i kërkon asaj që kutia përkatëse të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë.

KZAZ-ja, kur konstaton parregullsitë sipas pikave “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, vlerëson kutinë si të parregullt, i vendos etiketën “KUTI E PARREGULLT” dhe porosin menjëherë operatorin/ndihmësin teknik ta hedhë këtë fakt në sistemin elektronik.

g) Të gjitha mospërpunimet apo parregullsitë e konstatuara për secilën kuti votimi me fletët e votimit ose për secilën kuti me materialet e votimit të deklaruara të parregullta, shënohen nga KZAZ-ja në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit dhe nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim.

gj) Grupi i marrjes në dorëzim plotëson procesverbalin e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV-ja përkatëse, sipas formularit tip të përgatitur nga KQZ-ja.

h) Procesverbali i marrjes në dorëzim nënshkruhet nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari dhe sekretari i KQV-së, dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, i caktuar për shoqërimin e materialeve zgjedhore nga KQV-ja në VNV.

i) Origjinali i procesverbalit të marrjes në dorëzim administrohet nga KZAZ-ja, kopje të tij i jepen kryetarit, sekretarit të KQV-së, dhe punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili largohet menjëherë me marrjen e kopjes së procesverbalit.

Neni 7

Kutitë e deklaruara “KUTI E PARREGULLT”

1. Në rastet kur për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të kutisë/kutive të votimit dhe kutisë së materialeve të votimit:

a) Kutia/kutitë e votimit me fletët e votimit janë vlerësuar “KUTI E PARREGULLT”, atëherë kutia/kutitë me fletët e votimit dhe kutia përkatëse me materialet e votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta;

b) Në rastin e zgjedhjeve vendore, kur vetëm njëra nga kutitë e votimit me fletët e votimit është vlerësuar “KUTI E PARREGULLT”, atëherë vetëm ajo dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia tjetër e votimit dhe kutia e materialeve të votimit i nënshtrohet procedurave të numërimit sipas përcaktimeve të neneve 116 deri në 119 të Kodit Zgjedhor.

c) kutia/kutitë me fletët e votimit është/janë marrë në dorëzim të rregullta dhe kutia e materialeve të votimit është vlerësuar nga KZAZ-ja “KUTI E PARREGULLT”, ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit, së bashku me kutinë/kutitë e votimit me fletët e votimit. Në çdo rast, parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si “KUTI E PARREGULLT”, shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit.

2. Kutitë e votimit, të përcaktuara si “KUTI E PARREGULLT”, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe nuk i kalojnë GNV-ve për vlerësim. Këto kuti, dërgohen në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevojat e hetimit administrativ.

3. Kutitë me fletët e votimit të vlerësuara si “KUTI E PARREGULLT”, vendosen në vendin e veçantë të caktuar nga KZAZ-ja për kutitë e parregullta, së bashku me kutinë e materialeve të votimit të QV-së përkatëse. Bën përjashtim nga ky rregull rasti kur, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore kutia e materialeve të votimit shoqëron kutinë tjetër të votimit të asaj QV-je, e cila nuk është vlerësuar e parregullt.

Neni 8

Sistemimi i kutive me fletët e votimit dhe kutitë me materiale të votimit në VNV

1. KZAZ-ja, cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë e votimit dhe kutitë me materiale të votimit para numërimit dhe kutitë e votimit dhe kutitë me materiale të votimit pas numërimit, sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur udhëzimit nr. 4, datë 9.4.2015 të KQZ-së, si dhe një hapësirë për kutitë e vlerësuara “KUTI E PARREGULLT”.

2. Sapo kutitë e votimit dhe kutitë me materiale të votimit, janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e caktuar. Ky proces mbikëqyret nga KZAZ-ja.

3. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, renditen sipas numrit të qendrës së votimit. Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës së tyre. E para në radhë duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh. QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së mëmë.

a) Në zgjedhjet për Kuvend, kutitë e një QV-je vendosen në pozicion vertikal, njëra mbi tjetrën: poshtë kutia e materialeve të votimit dhe sipër saj kutia e votimit me fletët e votimit.

b) Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, KZAZ-ja i vendos kutitë e votimit të grupuara, sipas organit përkatës: fillimisht rendit në rend rritës kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë, në rreshtin e dytë rendit në rend rritës kutitë e votimit për këshillin e bashkisë, dhe në rreshtin e tretë rendit kutitë me materialet e votimit. Në këtë renditje, kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit të çdo QV-je janë bri njëra-tjetrës.

PJESA III FILLIMI I PROCESIT TË NUMËRIMIT

Neni 9

Personat e pranishëm në VNV

1. Gjatë procesit të numërimit të votave në VNV janë të pranishëm vetëm:

- a) anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së;
- b) anëtarët e grupeve të numërimit të votave të caktuar me vendim të KZAZ-së;
- c) përfaqësuesit e akredituar të medias;
- ç.) vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
- d) vëzhguesit e tjerë të akredituar;
- dh) kandidatët;
- e) operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave;
- ë) stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim nga KQZ-ja.

2. Të gjithë personat e pranishëm në VNV, duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre.

3. Personat e përmendur në gerrat “c”, “d”, “dh”, “e”, dhe “f” të pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin përkatës, akreditim apo autorizim, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

4. KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin në VNV të personave të tjerë, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 10

Veprime paraprake të KZAZ-së

KZAZ-ja, pasi sigurohet se janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, dhe pasi është siguruar që të gjithë anëtarët e GNV-ve, kanë marrë trajnimin e nevojshëm, merr masat paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave si më poshtë:

- a) Sigurohet që vendi i numërimit të votave është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave.
- b) Sigurohet që anëtarët e grupeve të numërimit janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat përkatëse të numërimit.
- c) Grupet e numërimit janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave.
- ç) Verifikon që të pranishëm në VNV, janë vetëm personat e parashikuar në nenin 9, të këtij udhëzimi.
- d) Në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore sigurohet se është kryer mbyllja e kutive të posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim, sipas procedurave të mbylljes të kutive të votimit përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
- dh) Merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

Neni 11

Fillimi i procesit të numërimit të votave

1. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave pasi ka marrë në dorëzim të

gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të në juridiksionin e saj. Në vendimin për fillimin e numërimit të votave shënohet ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave. Kryerja e procedurave për veprimet paraprahe të përcaktuara në nenin 10, dhe ora e fillimit të procesit të numërimit të votave shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

2. Kutitë e votimit me fletët e votimit të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit në VNV, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

3. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së.

4. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

Neni 12

Radha e numërimit në zgjedhjet e organet e qeverisjes vendore

1. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, numërimi fillon me votat për kryetarin e bashkisë dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin e bashkisë.

2. Numërimi i votave për këshillin e bashkisë fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për kryetarin e bashkisë.

PJESA IV

PROCEDURAT QË NDIQEN PËR NUMËRIMIN E VOTAVE NGA GRUPI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 13

Veprime paraprahe të GNV-së

1. Sekretari i grupit të numërimit ndjek procedurën si më poshtë:

a) Nën kujdesin e një anëtarë të ngarkuar nga KZAZ-ja, merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe e vendos atë pranë tavolinës së grupit të numërimit.

b) Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV. Në dosje ndodhet procesverbali i dorëzimit të kodeve të sigurisë së vulave dhe modeli krahasues i vulës së kryetarit të KQV-së.

Neni 14

Numërimi i votave

1. Numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë e votimit me fletët e votimit dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë dhe nxjerr nga kutia e votimit procesverbalin e mbylljes së votimit.

2. Grupi i numërimit të votave kryen procedurën e verifikimit të të dhënave në procesverbalin e mbylljes së votimit.

3. Në rast se procesverbali i mbylljes së votimit gjendet në kutinë e votimit dhe të gjithë rubrikat e tij janë plotësuar sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor, atëherë numërimi vazhdon sipas procedurave të përcaktuara nga ky nen. Në të kundërt, KZAZ-ja plotëson procesverbalin e konstatimit dhe GNV-ja vepron sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij udhëzimi.

4. Pas nxjerrjes së Procesverbalit të Mbylljes së Votimit, numëruesi i parë dhe anëtarët e grupit të numërimit, nxjerrin nga kutia procesverbalin e vulosjes dhe fletët e votimit dhe duke i shpalosur fletët e votimit dhe vendosur ato mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme.

5. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, kur gjatë këtij procesi konstatohen fletë votimi që i përkasin organit tjetër për të cilin është votuar, GNV i lë ato mënjanë të palosura dhe pa bërë vlerësim. Këto fletë votimi futen në zarfin “VOTA TË HEDHURA GABIM”.

6. Fletët e votimit të shpalosura dhe të stivuara numërohen nga numëruesi i parë, i cili, në përfundim të numërimit, ia bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

7. Shifra e deklaruar verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në procesverbalin për mbylljen e votimit.

8. Në rastin e zgjedhjeve vendore shifra e deklaruar, plus shifrën e votave të hedhura gabim kur ka të tilla, verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në procesverbalin për mbylljen e votimit.

9. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të grupit të numërimit,

numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe njëherë numërimin e fletëve të votimit.

10. Në rast se nga verifikimet e kryera, konstatohen mospërputhje, atëherë GNV-ja, ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi.

11. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri sa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë, e pasqyron atë në procesverbalin e konstatimit.

12. KZAZ-ja, vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në procesverbalin e konstatimit, merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ja bën vendimin menjëherë të ditur GNV-së.

Neni 15

Rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit

1. Kutia e materialeve të votimit hapet gjatë procesit të numërimit të votave në VNV vetëm në rastet kur procesverbali i mbylljes së votimit mungon në kutinë e votimit me fletët e votimit, ose nuk janë plotësuar të dhënat sipas përcaktimeve të nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

2. Grupi i numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatim, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi.

3. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

4. Në rast se KZAZ-ja konfirmon mungesën e procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit, pasaktësi ose parregullsi në plotësimin e tij, pasqyron faktet në procesverbalin e konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga grupi i numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV.

5. Pas njohjes me vendimin e KZAZ-së, numëruesi i parë vendos kutinë me fletët e votimit, numërimi i së cilës është pezulluar, pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse.

Neni 16

Hapja e kutisë së materialeve të votimit Procedurat dhe radha e veprimeve të GNV-së

1. Numëruesi i parë hap kutinë e materialeve të votimit, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Në fillim verifikohet nëse në kuti ndodhet procesverbali për mbylljen e votimit, i plotësuar sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

2. Kur procesverbali për mbylljen e votimit i plotësuar sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor, gjendet në kutinë e materialeve të votimit, GNV ia dorëzon atë KZAZ-së e cila pasqyron faktin në procesverbalin e konstatimit.

3. Pas kryerjes së procedurave të pikës 1 dhe 2 të këtij neni, sekretari i grupit të numërimit shënon numrat e kodeve për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, në procesverbalin e grupit të numërimit që përdoret në këtë procedurë, e fut atë në kutinë e materialeve të votimit, dhe kopje të tij ia dorëzon KZAZ-së. Më pas numëruesi i parë i grupit të numërimit mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie.

4. Numëruesi i parë vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV-ja vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 17 të këtij udhëzimi.

5. Kur procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit apo nuk është plotësuar sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor, grupi i numërimit plotëson procesverbalin e konstatimit dhe më pas ndjek këto procedura:

a) verifikon nëse në kuti ndodhen:

i) zarfi “FLETË VOTIMI TË PAPËR-DORURA”;

ii) zarfi “FLETË VOTIMI TË DËM-TUARA”;

iii) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të Kodit Zgjedhor;

iv) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së;

v) vula e KQV-së;

vi) vula e kryetarit të KQV-së;

- vii) vulat me kodet e sigurisë të përdorura;
 - viii) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka;
 - ix) Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së; dhe
 - x) dokumentacioni shoqërues i fletëve të votimit me seritë përkatëse;
- b) Numëruesi i parë krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ia bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit;
- c) Pasi ka kryer procedurat e mësipërme, numëruesi i parë numëron:
- i) fletët e votimit të përdorura;
 - ii) fletët e votimit të dëmtuara;
 - iii) zgjedhësit që kanë votuar, sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve, përfshirë edhe ata, emri i të cilëve është shënuar në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve.
- ç) Për çdo rast, të parashikuar në germen "c" të këtij neni numëruesi i parë në fund të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të grupit të numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin.
- d) Numëruesi i parë, hedh të dhënat për numrin total të fletëve të votimit të dorëzuara në KQV, sipas dokumentacionit shoqërues të tyre.
- dh) Numëruesi i parë, hedh të dhënat në tabelën e rezultateve për qendrën e votimit për:
- i) numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
 - ii) fletë votimi të përdorura;
 - iii) fletë votimi të dëmtuara.
- e) Sekretari i grupit të numërimit shënon numrat e kodeve në procesverbalin e mbylljes së kutisë së materialeve të votimit, e fut atë në këtë kuti dhe më pas numëruesi i parë i grupit të numërimit mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie. Kopje të këtij procesverbali i dorëzohet KZAZ-së e cila shënon numrat e kodeve të vulave të sigurisë në librin e protokollit.
- ë) Numëruesi i parë e vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit, dhe merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 17 të këtij udhëzimi.

Neni 17

Vlerësimi i votave

1. Fletët e votimit të vlerësuara nga grupi i numërimit, ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme dhe në fletë votimi të kontestuar.
2. GNV-ja bën ndarjen e hapësirës së tavolinës së numërimit, duke përcaktuar vendet e veçanta për fletët e votimit: të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuar. Në hapësirën e tavolinës së numërimit të caktuar për votat e vlefshme, GNV-ja përcakton vende të veçanta për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor, duke pasur parimin, fletët e votimit të partive të të njëjtit koalicion zgjedhor, grupohen veçmas dhe pranë njëra-tjetrës.
3. Numëruesi i parë hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, i vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së.
4. Gjatë shfaqjes të fletës së votimit, nga faqja e pasme numëruesi i parë verifikon nëse fleta e votimit:
 - a) ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja.
 - b) është vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së.
 - c) në fletën e votimit janë bërë shënime, shenja apo nënshkrime që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit.
5. Gjatë kryerjes së kësaj procedure, numëruesi i parë shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.
6. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e caktuar për fletët e votimit të kontestuar dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Kjo fletë votimi, do të vlerësohet përsëri nga grupi i numërimit në momentin e rivlerësimit të votave.
7. Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure, për fletën e votimit të vlerësuar e pavlefshme, nuk ka pasur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e

punës së GNV-së.

8. Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

9. Grupi i numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit.

10. Numëruesi i parë i grupit të numërimit, në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e pavlefshmërisë së votës të parashikuar në nenin 117, pika 3, të Kodit Zgjedhor, dhe në fletën e votimit:

a) është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore;

b) nuk janë bërë shënime në favor ose disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;

c) nuk është votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit;

ç) nuk është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

çmon dhe pastaj u propozon për vlerësim anëtarëve të tjerë, se cilës parti politike apo kandidati i është hedhur vota.

11. Numëruesi i parë, gjatë kryerjes së kësaj procedure, është i detyruar t'ia tregojë çdo fletë votimi anëtarëve të grupit të numërimit dhe të vendosë çdo fletë votimi në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që të shikohet qartësisht në monitor shenja, e cila tregon vullnetin e zgjedhësit.

12. Gjatë shfaqjes së fletës së votimit në kamerën regjistruese numëruesi i parë i grupit të numërimit, bën vlerësimin e votës me zë të lartë.

13. Në rast se anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim, janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për partinë politike apo për kandidatin për të cilin është votuar. Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedurë.

14. Gjatë vlerësimit të votave, në asnjë rast dhe për asnjë arsye fletët e votimit nuk shfaqen më shumë se një herë në kamerë.

Neni 18

Kontestimi dhe rivlerësimi i votës

1. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose vëzhguesit e tavolinës së numërimit përkatëse, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

2. Kontestimi i votës bëhet duke ngritur dorën e duke thënë “NUK JAM DAKORD”.

3. Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit, Grupi i Numërimit rivlerëson fletët e votimit të kontestuara.

4. Rivlerësimi bëhet nga Grupi i Numërimit dhe nuk i nënshtrohet procesit të shfaqjes së fletëve të votimit të kontestuara në kamerë.

5. Gjatë procesit të rivlerësimit, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë të kontestojnë vlerësimin e votës dhe as të kërkojnë rishfaqjen e votave në monitor. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit.

6. Në rast se edhe pas rivlerësimit nga GNV-ja, ka fletë votimi të kontestuara nga të paktën një anëtar i GNV-së, atëherë GNV-ja thërret KZAZ-në për vlerësimin e votave të kontestuara të asaj kutie.

7. KZAZ-ja bën në çast vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje me të, duke e vlerësuar atë votë të vlefshme apo votë të pavlefshme. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezulttit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave.

8. Për secilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i grupit të numërimit shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit. Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse, shënohet nga GNV në Procesverbalin përkatës miratuar me vendim të KQZ-së.

9. Në përfundim të nxjerrjes së rezulttit për QV përkatëse, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “FLETËVE TË VOTIMIT TË KON-TESTUARA”.

Neni 19

Numërimi i votave të çdo subjekti zgjedhor

1. Pas numërimit dhe vlerësimit të votave për çdo kuti votimi, numëruesi i parë numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit. Pas çdo numërimi, shifrën ia bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Në rast se kërkohet nga ndonjë anëtar i grupit të numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë subjekt.

2. Në rast se, edhe pas këtij numërimi të dytë ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë ose anëtari kundërshtues, njofton KZAZ–në nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ–ja. KZAZ–ja numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron grupin e numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

Neni 20

Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga grupi i numërimit

1. Pas përfundimit të procedurave të numërimit dhe vlerësimit të votave për qendrën e votimit, numëruesi i parë së bashku me anëtarët e grupit të numërimit, plotësojnë tabelën e rezultateve të QV-së, sipas formularit tip të miratuar me vendim të KQZ-së. Para plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së përkatëse, grupi i numërimit të votave kontrollon dhe sigurohet që:

a) numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme me votat e vlefshme dhe votat e hedhura gabim, kur ka të tilla;

b) numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për subjektet zgjedhore të shënuara në fletën e votimit.

2. Në rast se kanë kundërshtime për rezultatet e pasqyruara në tabelë, anëtarët e GNV-së, bëjnë shënimet në rubrikën përkatëse të tabelës së rezultateve. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave janë të detyruar të nënshkruajnë tabelën e rezultateve të QV-së, votat e së cilës i kanë numëruar.

3. Tabela e rezultateve, e plotësuar nga anëtarët e grupit të numërimit, duke përfshirë edhe kundërshtimet, nëse ka, shfaqet në kamera për jo më pak se 5 sekonda.

4. Tabela origjinale e rezultateve për qendrën e votimit, i dorëzohet menjëherë dorazi KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së ia përcjell tabelën e rezultateve, operatorit teknik për transmetimin e të dhënave në rrugë elektronike nga VNV-ja në KQZ, sipas pikës 6 të udhëzimit të KQZ nr. 1, datë 20.2.2015. Pas transmetimit të të dhënave të rezultateve të QV-së në KQZ, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë tabelën origjinale të rezultateve për QV të plotësuar e firmosur nga GN-ja dhe ta transmetojë atë në KQZ.

5. Pas transmetimit të të dhënave në KQZ, kopje të tabelës së rezultatit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, i jepen çdo anëtari të GN-së përkatëse, dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

6. Nëse ndonjë nga vëzhguesit e tavolinës ku u krye numërimi ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen menjëherë në librin e protokollit të KZAZ-së.

Neni 21

Mbyllja e kutisë me fletët e votimit

1. Pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së nga GNV-ja, fletët e votimit të futura në zarfe të ndara, sipas subjekteve zgjedhore. Votat e pavlefshme futen në zarfin “VOTA TË PAVLEFSHME”, fletët e votimit të kontestuara janë grupuar më vetë dhe futen në zarfin me shënimin “FLETË VOTIMI TË KONTESTUARA” sipas pikës 9, të nenit 16, të këtij udhëzimi.

2. Më pas të gjitha këto zarfe, përfshi zarfin me procesverbalin për hapjen e votimit dhe zarfin me procesverbalin e mbylljes së votimit, futen në kutinë e votimit e cila mbyllet me vula me kode të reja, të cilat shënohen në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit.

3. Grupi i numërimit merr nga stiva e kutive të votimit kutitë me fletët e votimit të qendrës tjetër të votimit, vetëm pasi ka dërguar në vendin e caktuar brenda sallës së vendit të numërimit të votave kutitë e përpunuara dhe i ka dorëzuar KZAZ-së tabelën e rezultateve përkatëse për qendrën e votimit të numëruar.

PJESA V

ADMINISTRIMI DHE NUMËRIMI I VOTAVE TË HEDHURA GABIM NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Neni 22

Administrimi i votave “të hedhura gabim”

1. KZAZ-ja disponon dy kuti votimi, njëra për votat e hedhura gabim në kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë, dhe tjetra për votat e hedhura gabim në kutitë e votimit për këshillin e bashkisë. Hapja dhe mbyllja e këtyre dy kutive të votimit kryhet nga KZAZ sipas të njëjtave procedura që hapen dhe mbyllet kutitë e votimit.

2. Numëruesi i parë, në përfundim të kutisë së fundit që numëron GNV-ja përkatëse, plotëson procesverbalin e konstatimit për votat e hedhura gabim sipas formularit tip të miratuar nga KQZ-ja, ku shënon numrin e votave të hedhura gabim për secilin organ që gjenden në secilin zarf të “VOTAVE TË HEDHURA GABIM” për çdo QV që ka numëruar GNV-ja.

3. Procesverbali i konstatimit ku janë shënuar numri i fletëve të hedhura gabim për çdo kuti votimi të numëruar, bashkë me zarfet përkatës të mbyllur “VOTA TË HEDHURA GABIM” i dorëzohen sekretarit të KZAZ-së.

4. Sekretari i KZAZ-së hap zarfet, shënon në librin e protokollit të mbledhjeve numrin e QV-së së numëruar, organin për të cilin është votuar në atë kuti, që i korrespondon zarfi përkatës, numrin e fletëve të hedhura gabim të gjendura në secilin zarf, dhe hedh këto vota në kutinë e posaçme përkatëse, pa i hapur fletët e votimit.

Neni 23

Numërimi i votave “të hedhura gabim”

1. Në përfundim të numërimit të votave për të gjitha kutitë e ZAZ-së, KZAZ-ja cakton menjëherë një prej grupeve të numërimit të votave për kryerjen e vlerësimit dhe numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara për secilin organ, të administruara sipas nenit 22 të këtij udhëzimi.

2. Kutia me vota të hedhura gabim për një organ hapet pas përfundimit të numërimit të kutive për organin përkatës.

3. Grupi i numërimit, i caktuar për kryerjen e kësaj procedure, fillimisht merr nga sekretari i KZAZ-së procesverbalin e vulosjes me kodet e sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia përkatëse dhe verifikon përpunshmërinë e numrave të vulave të kodeve të sigurisë. Në rast se konstatohen mospërpunje, njoftohet menjëherë KZAZ-ja e cila merr vendim sipas nenit 6, pika 1, germa “F” të këtij udhëzimi.

4. Në rast se nga verifikimi i GNV-së nuk rezultojnë mospërpunje të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia përkatëse, atëherë GNV-ja kryen, për aq sa është e mundur, procedurat si në nenet 14, pika 1, 17, 18, 19, 20, 21 të këtij udhëzimi. Rezultati i secilës kuti me vota të hedhura gabim, hidhet në një tabelë rezultatesh të veçantë për votat e hedhura gabim, e miratuar me vendim të KQZ-së. Në këtë tabelë përcaktohet organi për të cilin janë hedhur votat.

PJESA VI

NXJERRJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE NGA KZAZ-JA

Neni 24

Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja në zgjedhjet për Kuvend

1. Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave tabelën përmbledhëse të rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti për çdo qendër votimi, sipas origjinalëve të tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit.

2. Tabela përmbledhëse e rezultateve të ZAZ-së, e printuar, pasi kontrollohet nga anëtarët miratohet me vendim të KZAZ-së. Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ tabela përmbledhëse e rezultateve për ZAZ-në përkatëse të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

3. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

4. Kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

Neni 25

Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për kryetarin e bashkisë

1. Në përfundim të numërimit të të gjitha kutive të votimit për kryetarin e bashkisë, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave tabelën përmbledhëse provizore të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo kandidati për çdo qendër votimi.

2. Tabela përmbledhëse provizore të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë, nuk përmban rezultatin e kutisë me vota për kryetarin, por të hedhura gabim në kutinë e këshillit të bashkisë.

3. Rezultati i pasqyruar në tabelën përmbledhëse provizore të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin nuk është përfundimtar. Kjo tabelë dhe çdo publikim i saj përmban shënimin se rezultati nuk është përfundimtar.

4. Në përfundim të procedurës së përcaktuar në nenin 23 të këtij udhëzimi, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, tabelën përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetar të bashkisë.

5. Tabela përmbledhëse e rezultateve të ZAZ-së, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja.

6. Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ tabelën përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

7. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

8. Kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

Neni 26

Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për këshillin e bashkisë

1. Në përfundim të numërimit të të gjitha kutive të votimit për këshillin e bashkisë, përfshirë dhe kutinë e posaçme me votat e hedhura gabim, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, tabelën përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë.

2. Tabela përmbledhëse e rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja. Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ tabelën përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

3. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

4. Kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

PJESA VII HYRJA NË FUQI

Neni 27

Shfuqizime

Udhëzimi i KQZ-së nr. 18, datë 3.06.2009 “Për mënyrën e organizimit të punës në VNV, rregullat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja dhe GNV-të, radhën e veprimit dhe ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit të votave”, dhe udhëzimi i KQZ-së nr. 2, datë 18.04.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.18, datë 03.06.2009 “Për mënyrën e organizimit të punës në VNV, rregullat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja dhe GNV-të, radhën e veprimit dhe ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit të votave”, shfuqizohen.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Lefterije Luzi**

